



Dalës-Izlazna

Nr. 1-141  
Br.

Data 10.08.2019  
Datum

OBILIC-ORUJIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Kuvendi Komunal Obilić - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilić

Në mbështetje të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenit 61 të Statutit të Komunës së Obiliqit, caktoj:  
Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa me dt. 27.08.2019, ( e martë) në ora 10:00 në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

## R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Draft-Rregullores Për Ndarjen e Bursave , Kompensimin e Shpenzimeve të Udhëtimit dhe Aktiviteteve Jashtëshkollore .
4. Shqyrtimi i Draft-Planit Strategjik Parësor Shëndetësor për Komunën e Obiliqit
5. Shqyrtimi i kërkesës së DKRS-së, për dhënin në diskutim publik të Draft Rregullorës për Administrimin e Shtëpive të Kulturës në Komunën e Obiliqit
6. Shqyrtimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës, për shpallje me interes të përgjithëshëm publik për parcelat kadastrale në zonën kadastrale në Caravodicë
7. Shqyrtimi i Propozim Vendimeve të Kryetarit të Komunës për dhëni e pronës komunal në shfrytëzim afatgjatë në Llazarevë :
  - a) Investitori : Kolegji BIZNESI ,Prishtinë .
  - b) Investitori :APOLLONIA ,SH.P.K
8. Shqyrtimi i kërkesës së MAPL-së ( rishikimi i vendimit nr I-106, të dt.28.06.2019 )
9. Shqyrtimi i kërkesave
10. Të ndryshme





Dalës-Izlažna

Nr. 1-142  
Br.

Data 19.08.2019  
Datum

OBILIĆ-OBLIĆ



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova

Kuvendi Komunal Obilić - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilić

## E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.18.07.2019, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm janë këta anëtarë:** Burim Gërguri, Florije Jashari, Qëndresa Dubova, Linda Sadiku, Fatmir Bekteshi, Hysni Mjeku, dhe Slavisa Spasic

**Te pranishmit tjere:** Ibush Mjekiqi, Nënkyetar i Komunës, Arben Berisha, drejtor i DPUKP, Zarife Behluli, drejtoreshë e DEFZH, Naim Miftari, drejtor i DSHPE-së, Vlora Kabashi, drejtoreshë e DSHMS-së, përf.i IZHL-së dhe përf.e KFOR-it

**Burim Gërguri:** I përshëndeti të pranishmit dhe i njoftoi se arsyja që po mbahet mbledhja më heret është për shkak të pushimeve.

Po ashtu, kryesuesi i njofton që prej 1 shtatori Kryetari do të ju dërgoj draftin për planifikim buxhetor në bazë të nenit 52, të Ligjit për qeverisje lokale është caktuar edhe mbledhja për Komitetin për Politikë dhe Financa me datën 18/07/2019 e enje ora 10:00 dhe fillon me këtë rend të ditës :

- 1) Arsyetimi për mungesë
- 2) Aprovimi i Ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- 3) Shqyrtimi i raportit finansiar 6-mujor I Ekzekutivit të Komunës
- 4) Shqyrtimi i raportit 6-mujor të KKBS-së
- 5) Shqyrtimi i kërkesës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për dhënien në diskutim publik të Planit strategjik paqësor shëndetësor për Komunën e Obiliqit
- 6) Shqyrtimi i kërkesave
- 7) Të ndryshme

**Burim Gërguri** - Aprovohet rendi i ditës dhe sqarohet arsyetimi për mungesë.

**Burim Gërguri** – Hap debat rrëth pikës së dytë për ekstraktin e procesverbalit, ku bëhet edhe aprovimi i pikës se 2-të.

Sa i përket pikës së tretë kryesuesi e lutë drejtoreshën të sqaroj raportin 6-mujor finansiar .

**Zarife Behluli** - Jep raport për raportin finansiar – Raporti është punar për 5 kategoritë ekonomike, ku përfshihen paga dhe meditje, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, suvencione dhe transfere dhe shpenzime kapitale.

Në gjashtë mujorin e parë të hyrat vetanake i kemi realizuar 64..... nga planifikimi i 1 milion.... që do të thotë janë realizuar rrëth 62.2% dhe 37.8% janë ende të parealizuara .

Sa i përket shpenzimeve kapitale, buxheti është më i madh dhe përfshin shtrimin e rrugëve me zhavor, ndriqimi publik, rregullimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, irregullimi i varrezave ende te pazotuara mjetet, ndërtimi i stacioneve të qytetit (10.000) në zotim, hartimi i projekteve, rregullimi i kanalizimit në Obiliq. Asfaltim i rrugeve rurale ... te bashkëfinancimi .... Hartimi sezonal dhe hartat .. kogjenerimi .. furnizim me kontejnerë ... mbjellja e drunjëve ... irregullimi dhe rritja e sipërfaqeve me gjelbërim ... parqet në Obiliq... inventari për QKMF- Në zotim, pajisje elektrike, pajisje mjekësore, ultrazëri, laborator për analiza, digitalizimi QKMF dhe QMF, irregullimi i fushave sportive, fusha e trashëgimisë kulturore, renovimi i fushës sportive ...shtatorja Xhavit Haziri, inventar për Shtëpi të kulturës , irregullimi i oborrit dhe rrethojave të shkollave, sallat në shkollën e mesme dhe asaj në Milloshevë ... renovimi i shkollave në Obiliq .. huamarra për arsim .. te arsimi fillor mallra....donacionet në bujqësi .... kështu që në total buxheti 6 mujor është 6 milion.....

Votohet dhe merret rekomandim për raportin financiar 6-mujor për Ekzekutiv.

**B.Gërguri** - Kalohet në pikën e katërt shqyrtimi i raportit të KKBS-së, fjalën e merrë Suzana Hashani.

**Suzana Hashani** – Sqaron rrith raportit, se në atë raport është e përfshirë vetëm puna rrith KKBS-së dhe se deri në qershor janë të obliguar të mbajnë tri mbledhje. Kur mbahet mbledhja për Komitete, komandanti i policisë raporton për ngjarjet që ndodhin në Komunën tonë dhe deri më tash situata ka qenë relativisht e mirë. Zakonisht probleme të mëdha nuk ka mirëpo gjithmonë ekzistojnë shqetësimi rrith vjedhjeve, qenve endacakë, sigurisë për shkolla etj. Ndër shqetësimet më të mëdha kanë qenë rrith vjedhjes, që është bërë në xhami dhe në kishën ortodokse-sérbe në Babimoc, ku të gjithë e kanë denuar këtë veprim.

Si shqetësim tjetër është shqetësimi rrith ndriqimi të rrugëve, ku është duke u marrë me atë punë Drejtoria për shërbime publike.

**Burim Gërguri** - KKSBB-ja, është siguri publike, si problem më i madh dhe unifikues për komunitete është punësimi. Sa i përket ndriqimit, jemi duke punuar rrith tyre ku jemi një ndër Komunat e para dhe se investimet kapitale nuk kanë pasur dallim mes fshatrave dhe komuniteteve, shumë nga rrugët kanë përfunduar që lidhin Obiliqin me Vushtrrinë dhe ajo që e lidhë një pjesë të Hamidisë me Plemetinin, bashkë me urën e cila është mundësi për krejtë ata që merren me blegtori etj.

Si rast tjetër që është lajmëruar si shqetësim ka qenë edhe dhuna në familje, e cila është denuar. Votohet dhe rekomandohet për Kuvend shqyrtimi i rapporti 6 mujor i KKSBB-së.

#### **Pika e pestë e rendit të ditës**

**Burim Gërguri** – Paraqet kërkesën nga drejtori i QKMF-së, ku thote se Komisioni i formuar nga Kryetari i Komunës dhe Komisioni në kuadër të QKMF-së, që nga viti 2018 është duke u punuar në hartimin strategjik të kujdesit parësor shëndetësor për Komunën e Obiliqit, nën mbikqyrjen e organizatës zvicerane. Ky plan është në përfundim.

**Nënkryetari** - Qe 4vite, jemi në mesin e 12 Komunave, që jemi partner te - OJQ ose ndryshe kujdesi cilësor dhe i qasshëm shëndetësor. Në kuadër të këtij programi në vitin 2018, Kryetari ka marrë vendime për formimin e Komisionit për hartimin e strategjisë për kujdesin parësor shëndetësor, strategji ose plan për 5 vitet e ardhshme se si do të zhvillohet kujdesi parësor shëndetësor ai kërkon nga të pranishmit që të aprovohet dhe pastaj të hapet debat publik për te në Kuvend.

Votohet dhe rekomandohet për Kuvend.

#### **Pika e gjashtë e rendit të ditës**

**Burim Gërguri** - Ka disa kërkesa, mirëpo një kërkesë më zyrtare është nga Ismajl Osmani – për DPUKP-në, nga banorët e fshatit Llazarevë. Ata kërkojnë dhënien e lejes për ndërtimin e një shtëpie për nevojat e fshatit.

Kryesuesi kërkon nga Nënkryetari që në mbledhjen e gushtit t'ju kthehet një përgjegje rreth kësaj kërkesë.

Kërkesë tjetër është nga Fidaim Pllana, nga fshati Lajthishtë i cili kërkon leje për ndërtimin e një shtëpie në fshatin Lajshtishtë, ku me kontributin e të afërmëve ka mbledhur mjete financiare për ndërtimin e shtëpisë.

Kërkesa tjetër është nga drejtori i DKA-së, i cili kërkon të aprovohet kërkesa për fillimin e procedurave për plotësim ndryshimin e Rregullores për ndarjen e bursave, kompensim dhe shpenzime të udhetimeve .

Kërkesa është aprovuar para 3 muajve dhe kërcohët nga zyra ligjore, të merret një përgjegje se a kemi të drejtë të bëhet përsëri ndryshim i saj .

Kërkesa tjetër është nga Elesa Terbunja, i cili kërkon përkrahje financiare për kampin veror për persona me aftësi të kufizuara, organizuar nga Handikosi .

**Nënkryetari** – DSHMS-ja, mund te kthej përgjegje mirëpo për ndihmë financiare nuk besoj se munden të gjenden mjete.

#### Pika e shtatë e rendit të ditës

**Burim Gërguri** - Sqaron përgjegjet e kërkesave, kërkesa nr.1, është për Drejtorinë e bujqësisë, kërkesa tjetër është për DEFZH, ndërsa kërkesa tjetër për DPUKP.

E kemi përgjegjen nga drejtori Naim Miftari, për banorët e Grabovcit se zyrtari për trafik dhe transport ka potencuar se shumë shpejtë do të përfundojë situacioni rrugor dhe do të përforcoj sigurinë në komunikacion si dhe do të kërcohët nga policia të shtohet patrollimi në këtë zonë.

Po ashtu, kemi përgjegjen nga drejtori i bujqësisë, i cili e njofton palën se kërkesa e tyre është refuzuar për arsy se Komuna, i ka planet dhe projektet e saj për subvencionim të fermerëve.

Përgjegje nga DPUKP-ja, për Besnik Kastratin nga fshati Breznicë, i cili ka kërkuar leje ndërtimore dhe njofton që palët nuk munden me u pajisë me atë leje për shkak se është duke u hetuar nga njësia për krime ekonomike.

Përgjegja tjetër është për kërkesën e Ragip Palojës, i cili ka kërkuar leje ndërtimore për rindërtimin e një objekti të djegur gjatë luftës, që nuk është marrë ende një përgjegje për te.

Përgjegje tjetër është për kërkesën nga Fatos Pllana, i cili ka kërkuar të pajiset me leje ndërtimi është refuzuar sepse ajo parcelë nuk ka dalje në rrugë.

Përgjegje tjetër shtë për kërkesën nga Shqiprim Gashi, nga fshati Sibofc i cili kërkon legalizimin e objektit për banim në fshatin Sibofc dhe njofton se ai objekt nuk mund të legalizohet për shkak se ende nuk ka filluar procedura e legalizimit.

**Burim Gërguri** – Në fund njofton se nga Ministria e administrimit të pushetit lokal e kemi shkresën përcjellëse, vendimin nr. 1/86 për aprovimin e planit të veprimit për eficiencë të energjisë 2019/21.

Mbledhja përfundoi në ora 11:1'

Prosesmbajtësja  
Suzana Hashani



Kryesuesi i Komitetit  
Burim Gërguri